



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 29
13 korrik – 19 korrik 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Përqindja e plotësueshmërisë				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	12 / 13	92%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	28 / 28	100%
		Librazhd	12 / 12	100%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%

	Kukës	Pukë	11 / 11	100%
		Kukës	13 / 14	93%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbin	4 / 5	80%
		Mirditë	4 / 6	67%
VLORE	Vlorë	Vlorë	22 / 22	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	6 / 6	100%
	Gjirokastrë	Gjirokastrë	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	424 / 429	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 29

	JAVA 29
Diarre pa gjak	2973
Diarre me gjak	0
Infeksione respiratore të sipërme	4997
Infeksione respiratore të poshtme	1760
Rash me temperaturë	18
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i njësive raportuese	424
% e njësive raportuese	99% (425/429)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:



Durrës – 9 raste

Tiranë – 3 raste



Vlorë – 2 raste

Fier – 3 raste

Lezhë – 1 rast


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve.**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave.**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet ulje në javën 29 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 28.

Grafiku 3. Trendi në kohë i diarreve pa gjak sipas javëve.**Grafiku 4. Shpërndarja e diarreve pa gjak sipas grup-moshave**


Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 29 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 28.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 20 – 29 të vitit 2025 dhe vitit 2026. Numri i rasteve.




Në javën 29 të vitit 2026 vërehet një ulje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.


Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000).



Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 28/2026 dhe 29/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një rritje e lehtë e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreve pa gjak” në javët 20-29 të vitit 2025 dhe 2026. Numri i rasteve.

Në javën 29 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i lartë i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 28-29 2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Vlorë, ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme. Kjo rritje lidhet edhe me faktorët sezonalë dhe lëvizjet më të shpeshta të popullsisë gjatë sezonit veror, si dhe me raportimin e qendrave verore në sistem.

Ngjarje ndërkombëtare

Malaria e lidhur me aeroportin e Frankfurtit (17.7.2026)

Katër raste të malaries nga *Plasmodium falciparum* janë identifikuar te persona që kishin punuar në aeroportin ndërkombëtar Frankfurt/Main përpara fillimit të simptomave (4–6.7.2026). Autoritetet gjermane të shëndetit publik kanë nisur hetimin epidemiologjik për të përcaktuar rrugën e mundshme të transmetimit.

Një prej rasteve është një burrë 55-vjeçar nga Rumania, elektrikist në Terminalin 3 të aeroportit, pa histori udhëtimi në zona endemike dhe pa transfuzione gjaku. Ai zhvilloi malarie të rëndë me insuficiencë multiorganore, u diagnostikua me *P. falciparum* në ekzaminimin e gjakut dhe u trajtua me artesunate intravenoz, me ecuri klinike të favorshme.

Nga katër rastet e identifikuara, tri janë diagnostikuar në Gjermani dhe një në Rumani. Të gjithë rastet kishin si element të përbashkët punën në aeroportin e Frankfurtit, çka sugjeron një transmetim të mundshëm të lidhur me aeroportin (airport malaria), ndërsa hetimet epidemiologjike dhe entomologjike vijojnë.

Gripi Avian A(H5N1) – Monitorimi i rasteve në njerëz

- Më 11 korrik 2026, Ministria e Shëndetësisë së Kamboxhias raportoi një rast njerëzor të infeksionit me virusin e gripit avian A(H5N1).
- Rasti është një fëmijë 9-muajsh, i shtruar në spital, ku po merr kujdes intensiv.
- Infeksioni u konfirmua laboratorikisht më 9 korrik 2026.
- Hetimet epidemiologjike për identifikimin e burimit të infeksionit dhe gjurmimin e kontakteve janë në vijim.
- Kontakteve të ngushta u është administruar profilaksi antivirale.
- Rreziku për popullatën e përgjithshme në BE/EEE nga gripi avian zoonotik A(H5N1) vlerësohet shumë i ulët.

Raste në njerëz me virusin e gripit të dërrit Influenza A(H3N2 v)

- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) raportoi një rast të konfirmuar laboratorikisht me virusin e gripit të dërrit Influenza A(H3N2) variant (H3N2v) në Brazil (shteti Santa Catarina), në raportin e publikuar më 7 korrik 2026.
- Rasti është një fëmijë, i cili zhvilloi simptomat më 12 qershor 2026.
- Infeksioni u identifikua fillimisht me test antigjenik për gripin A, ndërsa më 18 qershor 2026 u konfirmua si Influenza A(H3) me RT-PCR në kohë reale. Më 19 qershor 2026, analiza molekulare dhe sekuencimi gjenomik konfirmuan virusin Influenza A(H3N2)v.
- Gjyshi i fëmijës punonte në një fermë për rritjen e derrave dhe fëmija vizitonte rregullisht banesën e tij duke u ekspozuar ndaj derrave, çka sugjeron si burim të mundshëm infeksioni.
- Nuk janë identifikuar raste të tjera ndër kontaktet e ngushta.
- Rreziku i infektimit të njerëzve me virusin Influenza A(H3N2)v në BE/EEE vlerësohet i ulët.

Mpox në BE/EEE, Ballkanin Perëndimor dhe Turqi – 2026

- Gjatë qershorit 2026, në nëntë vende të BE/EEE u raportuan 129 raste të mpox të shkaktuara nga virusi i lisë së majmunit (MPXV) klada I, duke treguar një transmetim relativisht të qëndrueshëm pas rritjes së rasteve të vërejtura më herët gjatë vitit 2026.
- Në të njëjtën periudhë, gjashtë vende raportuan 22 raste të shkaktuara nga MPXV klada II, duke vijuar trendin në rënie.
- Transmetimi i të dy kladave vazhdon kryesisht brenda rrjeteve të meshkujve që kryejnë marrëdhënie seksuale me meshkuj (MSM), ndërsa shumica e rasteve janë regjistruar te persona të pavaksinuar.
- Ashpërsia e sëmundjes mbetet përgjithësisht e lehtë, me norma të ulëta shtrimi në spital për të dy kladat.
- Gjatë sezonit veror, për shkak të shtimit të udhëtimeve dhe organizimit të grumbullimeve masive, ekziston rreziku për rritje të mëtejshme të transmetimit.

Gripi Avian A(H5) – Monitorimi i rasteve në njerëz

- Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) raportoi një rast të konfirmuar laboratorikisht me virusin e gripit avian Influenza A(H5) në Bangladesh, në raportin e publikuar më 7 korrik 2026.
- Rasti është një fëmijë, i cili zhvilloi simptoma respiratore më 17 maj 2026.
- Infeksioni u konfirmua me RT-PCR në kohë reale më 11 qershor 2026.
- Nuk është raportuar histori ekspozimi e drejtpërdrejtë ndaj shpendëve, megjithëse në zonën përreth janë raportuar ngordhje të shpendëve; mostrat mjedisore rezultuan negative.
- Nuk janë identifikuar raste të tjera ndër kontaktet e ngushta të pacientit.
- Rreziku për popullatën e përgjithshme në BE/EEE nga viruset zoonotike të gripit avian A(H5Nx) vlerësohet i ulët.

Shpërthimi i sëmundjes Ebola nga virusi Bundibugyo – Republika Demokratike e Kongos dhe Uganda (2026)

- Deri më 16 korrik 2026, Republika Demokratike e Kongos (RDK) ka raportuar 2 124 raste të konfirmuara dhe 828 vdekje të lidhura me shpërthimin (bazuar në të dhënat deri më 15 korrik). Krahësuar me raportin e mëparshëm, janë regjistruar 51 raste të reja dhe 32 vdekje. Shpërthimi ka prekur pesë provinca: Ituri, North Kivu, South Kivu, Tshopo dhe Haut-Uele.
- Më 13 korrik 2026, një shtetas amerikan që punonte për një organizatë humanitare në përgjigjen ndaj shpërthimit në RDK u evakuua për trajtim mjekësor në Gjermani.
- Në Ugandë, nuk janë raportuar raste të reja që nga 21 qershori 2026. Deri tani janë regjistruar 20 raste të konfirmuara, përfshirë 2 vdekje.
- Bazuar në informacionin aktual, rreziku i infektimit për qytetarët e BE/EEE që jetojnë ose udhëtojnë në zonat e prekura vlerësohet i ulët, ndërsa rreziku i importimit të rasteve dhe transmetimit të mëtejshëm në BE/EEE mbetet shumë i ulët.
- ECDC vijon të monitorojë situatën përmes mbikëqyrjes epidemiologjike dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen e përgjigjes ndaj shpërthimit.

Survejanca sezonale e infeksioneve nga Virusi i Nilit Perëndimor (West Nile Virus – WNV) – 2026

- Që nga fillimi i sezonit të transmetimit të vitit 2026 dhe deri më 15 korrik, janë identifikuar 28 zona të prekura **nga** Virusi i Nilit Perëndimor (WNV) në pesë vende evropiane.
- Shpërndarja e zonave të prekura është si vijon:
 - **Itali** 17 zona
 - **Greqi** 5 zona
 - **Maqedoni e Veriut** 2 zona
 - **Rumani** 2 zona
 - **Spanjë** 2 zona

Situata tregon vazhdimin e qarkullimit sezonal të virusit në disa vende të Evropës, duke theksuar rëndësinë e mbikëqyrjes epidemiologjike dhe të masave për mbrojtjen nga pickimet e mushkonjave, veçanërisht gjatë muajve të verës.

Monitorimi sezonal i përshtatshmërisë mjedisore për rrezikun nga Vibrio spp. në ujërat bregdetare – Sezoni i plazhit 2026

- **Vibriozë** është një infeksion i shkaktuar nga bakteret Vibrio, të cilat gjenden natyrshëm në ujërat bregdetare, veçanërisht në ujëra të ngrohta dhe me kripësi të ulët (ujëra të njelmëta).
- Në Evropë, bakteret Vibrio zbulohen më shpesh gjatë stinës së verës, ndërsa Deti Baltik paraqet kushte veçanërisht të favorshme për zhvillimin e tyre për shkak të kripësisë së ulët.
- Rritja e temperaturave si pasojë e ndryshimeve klimatike pritet të favorizojë përhapjen dhe zgjerimin e zonave bregdetare të përshtatshme për shumimin e këtyre baktereve.
- ECDC monitoron vazhdimisht përshtatshmërinë mjedisore për rritjen e Vibrio spp. në ujërat bregdetare të vendeve të BE/EEE dhe publikon përditësime të rregullta përmes platformës Vibrio Viewer dhe raporteve mbi kërcënimet nga sëmundjet ngjitëse, me qëllim vlerësimin dhe komunikimin e rrezikut për shëndetin publik.

Ciklosporiaza – SHBA, 2026

- Më 16 korrik 2026, Qendra Amerikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC) publikoi një raport mbi një shpërthim të ciklosporiazës, të lidhur me konsumin e marules së grirë “iceberg”, të shërbyer në një zinxhir të madh restorantesh të ushqimit të shpejtë në pesë shtete.
- Deri më 17 korrik 2026, në SHBA janë konfirmuar 1 644 raste, përfshirë 141 shtrime në spital (8,6%), të raportuara në 34 shtete. Nuk është raportuar asnjë vdekje.
- Gjithashtu, rreth 5 100 raste të dyshuara janë në proces hetimi për konfirmimin e ciklosporiazës së fituar brenda vendit.
- Rastet i përkasin grup-moshës 2–95 vjeç (mosha mediane 44 vjeç), ndërsa 56% e të prekurve janë femra.